

VENDIM
Nr. 25, datë 15.2.2017

**MBI MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR.169
DATË 31.10.2016 “MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E DISA
NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E ERE-S NR. 103 DATË 23.6.2016 “MBI
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT E BLERJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETET E SHPËRNDARJES
DHE TË TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN DHE SHITJEN E ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË
SHËRBIMIT PUBLIK”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 19, pika “I”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.2.2017, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike për miratimin e një ndryshimi në vendimin e bordit të ERE-s nr.169, datë 31.10.2016 “Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e disa ndryshimeve në vendimin e ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, “Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”,

konstatoi se:

- Mbështetur në nenin 19 germa “I”, ERE miraton, me propozim të të licencuarve rregullat për:
i) shitjen, blerjen dhe shkëmbimin e energjisë elektrike, që kryhen nga prodhuesit dhe furnizuesit, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.

- OSHEE sh.a., me shkresën nr. 4118 prot., datë 1.2.2017, në cilësinë e të ngarkuarit me detyrimin e shërbimit publik, konstaton vështirësi në implementimin në afat të rregullave të përcaktuara në Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, sa përket ndërtimit të platformës IT.

- ERE ka nisur më herët procedurat për shqyrtimin e disa ndryshimeve në vendimin e ERE-s nr. 103 datë 23.6.2016, dhe është ende në fazën e shqyrtimit të tyre.

Për gjithë sa më sipër,

VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr.169, datë 31.10.2016 “Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e disa ndryshimeve në vendimin e ERE-s nr.103, datë 23.6.2016, Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, si më poshtë:

- “Rregullorja për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, hyn në fuqi brenda datës 30.4.2017”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti